

AKT THEMELIMI DHE STATUT: "Apex Smart Solutions" SH.P.K.

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR "Apex Smart Solutions" SH.P.K

AKT THEMELIMI DHE STATUT: "Apex Smart Solutions" SH.P.K

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "Apex Smart Solutions"
SH.P.K**

**STATUT
PER KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK, SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR: "Apex Smart Solutions" SH.P.K**

Sot më datë 14.02.2023, ne shtetasit si më poshtë, vijon:

Z. Arnold Kovaci, lindur me 19.11.1990, në Tiranë, qytetar shqiptar, banues ne Tiranë, mbajtes I leternjofitimit me numër Personal J06119002Q, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Z. Irsid Salku, lindur me 11.04.1989, në Mamurras, qytetar shqiptar, banues ne Tiranë, mbajtes I leternjofitimit me numër Personal I90411086E, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Z. Evisjon Slaku, lindur me 23.06.1990, në Tirane, qytetar shqiptar, banues ne Tiranë, mbajtes I leternjofitimit me numër Personal J00623053R, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;



Në mbështetje të dispozitave ligjore të Kodit Civil në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, vendosëm themelimin e Shoqërisë Tregtare "Apex Smart Solution" Sh.p.k., shoqëri private e së drejtës Shqiptare, krijimi, funksionimi I së cilës përcaktohet si më poshtë vijon:

**KREU
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1
EMERTIMI I
SHOQERISE**

- 1.1 Emri i shoqërisë me pergjegjësi së kufizuar është " **Apex Smart Solutions**" SH.P.K (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), person juridik privat I së drejtës Shqiptare, I themeluar dhe do të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri në llojin e saj është Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuara.
- 1.2 Veprimtaria dhe funksionimi I kësaj Shoqërie rregullohet sipas neneve të statutit të kësaj shoqërie dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqritë Tregtare".

**NENI 2
SELIA**



AKT THEMELIMI DHE STATUT: "Apex Smart Solutions" SH.P.K

- 2.1 Njësia Bashkiake Nr 9, Rruga "Reshit Petrela", Zona Kadastrale 8330, Numri pasurise 7/520/Nd-N2, Tirane.
- 2.2 Asambleja e Pergjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë dege dhe/ose zyra perfaqesimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3


VULA E SHOQERISE

- 3.1 Shoqëria ka vulën e saj, do të jetë si vijon: **"Apex Smart Solutions" SH.P.K.**
- 3.2 Të gjitha Aktet dhe dokumentat që do të nxjerrë Shoqëria drejtuar palëve të treta dhe publikut duhet të tregojnë qartë dhe të lexueshëm emërtimin (llojin) e Shoqërisë dhe pas emrit do të jenë fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara" ose shkurtimi sh.p.k. **"Apex Smart Solutions" SH.P.K.**
- 3.3 Shoqëria ka adresën e saj elektronike: apexsmarts1@gmail.com
- 3.4 Shoqëria ka nr. Kontakt të saj: +355696715555

NENI 4

OBJEKTI I SHOQERISE

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:
Projektimin, organizimin dhe dhenien e shërbimeve të contact center për llogari të saj dhe të palëve të treta si nepermjet telefonatave ashtu edhe nepermjet mesazheve, postes elektronike, catit, kanaleve sociale, faqeve të internetit; si dhe dhenien e shërbimeve të shitjes nepermjet telefonit, shitjes online të quajtur e-commerce, telemarketingut, rikuperimi i kredive, kerkimet e tregut, kujdesi ndaj klientit, dhe cdo gje tjetër që lidhet me konsumatorin perfundimtar, me të gjithë veprimtaritë e lidhura me permbushjen e shërbimeve si me siper. Organizimin dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme për, përfshire blerjen, mirembajtjen, marrjen dhe dhenien me qira të vendeve të punës të organizuara dhe jo të organizuara. Dhenien e konsulences teknike për shoqëritë tregtare, lidhur me veprimtari tregtare të kryera nga to, duke iu referuar në mënyrë të vecante kontrollit të menaxhimit dhe të konsulences drejtuese. Konsulence në fushën e informatikës për strategji, projektimin, zhvillimin, kolaudimin, zbatimin dhe mirembajtjen e cdo zgjidhje hardware dhe software; ofrimin e shërbimeve për përpunimin dhe ruajtjen e të dhenave të cdo lloji dhe natyre për palët e treta, duke përfshire organizimin dhe menaxhimin e skedareve kompjuterike, të qendrave të përpunimit të të dhenave, kryerjen e praktikave administrative të tilla si depozitim dhe kërkesë të certifikatave në cdo zyrë dhe / ose organ publik; projektimin, realizimin, tregtimin dhe dhenien në përdorim të programeve kompjuterike; projektimin, realizimin, mbledhjen e informacionit nga bota e internetit për krijimin e bazave të të dhenave (data base) dhe të shfrytëzimit të tyre për qëllime tregtare nepermjet grumbullimit, menaxhimit dhe ri shitjes së informacionit dhe të profileve të Klienteve. Trajnime profesionale në të gjitha fushat e mesiperme duke mos u limituar vetëm në to. Përgatitjen, prodhimin, realizimin dhe mirembajtjen e faqeve të internetit dhe



AKT THEMELIMI DHE STATUT: "Apex Smart Solutions" SH.P.K
faqeve sociale si dhe realizimin e fushatave reklamuese online. Shoqëria ka te drejte te ushtroje çfaredolloj veprimtarie tjeter te lejuar nga ligji dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

- 4.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:
- a) Mund të marrë pjesë dhe te jete e interesuar ne shoqeri dhe sipermarrje, shqiptare apo te huaja, qe kryejne aktivitetete te njëjta, te ngjashme apo te lidhura me aktiviteti n e saj ose te subjekteve pjesemarrrese;
 - b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë truallli apo objektesh, operatorë dhe administrues te strukturave turistike;
 - c) Mund te kryejë te gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose qe kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, te paluajtshme, tregtare dhe cdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.
- 4.3 Shoqëria mund te veprojë ne Shqipëri dhe jashtë saj dhe te kryejë do aktivitet tjetër te lidhur, ndihmës me qëllim te përmbushe ose te jetë i dobishëm për permbushjen e objektit te saj.

NENI 5 KOHEZGJATJA E SHOQERISE

5.1 Shoqëria do të zhvillojë Veprimtarinë e saj për një kohë pa afat.

5.2 Ajo mund të shpërndalet para afatit me vendim të Ortakut, ose per shperndarje e saj e percakton vetë legjislacioni ne fuqi.

KREU II


KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

NENI 6 KAPITALI I SHOQERISE

6.1 Kapitali i Shoqërisë ndahet në një numët kuotash, në raport me kontributin dhënë nga cdo ortak në Shoqëri. Cdo Ortak zotëron një kuotë të vetme në Shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të këtij ligji, gëzojnë cilësinë si një ortak I vetëm.

6.2 Kapitali fillestar për ushtrimin e veprimtarisë së Shoqërisë është 2,000.000 (dy milion) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve ne Kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontrubutet e tij si më poshte:

Faqe 7 nga 8



AKT THEMELIMI DHE STATUT: "Apex Smart Solutions" SH.P.K

1. **Z. Arnold Kovaci**, lindur me 19.11.1990, në Tiranë, qytetar shqiptar, banues ne Tiranë, mbajtes I leternjoftimit me numër Personal J06119002Q, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Zotërues i një kuote të me vlerë nominale 500,000 (pesqind mijë) lekë dhe përfaqëson 25% të Kapitalit Themeltar
2. **Z. Irsid Salku**, lindur me 11.04.1989, në Mamurras, qytetar shqiptar, banues ne Tiranë, mbajtes I leternjoftimit me numër Personal I90411086E, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Zotërues i një kuote me vlerë nominale 750,000 (shateqind e pesedhjete mijë) lekë dhe përfaqëson 37.5% të Kapitalit Themeltar
3. **Z. Evisjon Slaku**, lindur me 23.06.1990, në Tirane, qytetar shqiptar, banues ne Tiranë, mbajtes I leternjoftimit me numër Personal J00623053R, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Zotërues i një kuote me vlerë nominale 750,000 (shateqind e pesedhjete mijë) lekë dhe përfaqëson 37.5% të Kapitalit Themeltar.

Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëhere dhe do të paguhet nga ortakët 100 % (njeqind per qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë.

- 6.3 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 7

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHEGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT

- 7.1 Në rast se një ortak, apo një bashkëzoterues i një kuote humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmët persona, që do ti njihet titulli mbi kuotën nga Shoqëria por asnjë nga këto parashikime nuk cliron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga cdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit te Shoqërisë me disa trashëgimtare të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet te caktojnë një përfaqësues të përbashkët.
- 7.2 Personi që fiton te drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit te një ortaku mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjetër te caktuar prej tij si perfitues i kuotes . Nese personi i mesiperm zgjedh te behet zoterues i kuotes, ai njofton Shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese personi i mesiperm zgjedh te kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjetër atehere ai duhet ta kryeje ate nepermjet nje akti te vlefshem te transferimit te kuotes.
- 7.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes se jetës ose falimentimit te nje ortaku do te kete te drejtat qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesemarrjes ose te votes ne do mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne regjistrin tregtar si zoterues i kuotes.

NENI 8

AKT THEMELIMI DHE STATUT: "Apex Smart Solutions" SH.P.K

ZMADHIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te zmadhoje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme per zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve qe jane thirrur por nuk ishin te pranishem ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme qe vendosi per zmadhimin e kapitalit.
- 8.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithë ortaket do te kene te drejten te nenshkruajne zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne perpjesetim te drejte me kuotat qe zotero jne ne Shoqeri.
- 8.3 Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta e nenskrimit te pjeses se tyre, kapitali i panenshkruar mund te nenshkruhet nga ortaket e tjere . Ne kete rast, keta ortake mund te ushtrojne serish te drejten per nenskrimin e kapitalit, ne perpjesetim te drejte me kuotat e pjesemarrjes ne Shoqeri.

NENI 9

ZVOGELIMI KAPITALIT

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 te ketij Akti Themelimi dhe Statuti. Ne do rast, kapitali i Shoqerise nuk mund te zvogelohet nen kufirin e percaktuar me ligj.
- 9.2 Ortaket e perballojne zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, ne perpjesetim te drejte me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqerise.

KREU III

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 10

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 10.1 Asambleja e Pergjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Pergjithshme vendos mbi te gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi ne Republikën e Shqipërisë, sipas ketij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose do marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 10.2 Cdo ortak ka te drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Pergjithshme, të shprehe vullnetin e tij si dhe te votojë në përputhje me pjesët e kapitalit qe ai zotëron ne Shoqëri.
- 10.3 Cdo ortak mund te perfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga nje perfaqesues i deleguar me prokure me shkrim.
- 10.4 Ortaku nuk mund të delegojë te drejtën e votes per nje pjesë te kuotave te tij te kapitalit, nese ai voton personalisht per pjesën e mbetur.
- 10.5 Mbledhja e Asamblesë se Pergjithshme mund te mbahet brënda ose jashtë territorit te Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë së Pergjithshme nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen (*conference call*) audio ose video, ne perputhje me legjislacionin per shoqerite tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme dote quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nenshkruhet procesverbali perkates.

AKT THEMELIMI DHE STATUT: "Apex Smart Solutions" SH.P.K

- 10.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/et ose nga ortakët që përfaqesojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara të Shoqërisë, të paktën 15 (pese mbledhjet) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe oren e mbledhjes.
- 10.7 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pa varësisht nga keto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
- 10.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për do mbledhje midis personave të pranishëm.
- 10.9 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përshijne dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 10.10 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 10.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 9.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.
- 10.12 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të $\frac{3}{4}$ të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 11 ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 11.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej; **5 (pesë) vjetësh**. **Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.**
- 11.2 Administratori zotëron kompetencat e plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç; atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 11.3 Administratori vepron në përputhje me politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.
- 11.4 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti të interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo

AKT THEMELIMI DHE STATUT: "Apex Smart Solutions" SH.P.K

veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhezimeve nga Asambleja e Pergjithshme.

11.5 Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë :

- **Z. Irsid Salku, lindur me 11.04.1989, në Mamurras, qytetar shqiptar, banues ne Tiranë, mbajtes I leternjofitimit me numër Personal I90411086E, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;**

NENI 12

SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

12.1 Asambleja e Pergjithshme percakton shperblimin e Administratorit të Shoqërisë.

NENI 13

PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT

13.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- (a) i përfundon mandati;
- (b) shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- (c) jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqerine;
- (d) personi nuk gezon cilesine e Administratorit sipas parashikimeve te ligjit;
- (e) mungon pa arsye ne detyre per me shume se 6 (gjashte) muaj radhazi dhe Asambleja e Pergjithshme vendos ta shkarkoje nga detyra.

KREU V

KONTROLLI FINANCIAR I SHOQERISE, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI

NENI 14

KONTROLLI FINANCIAR

14.1 Kontrolli financiar i Shoqërise kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emëroje një apo me shume Eksperte Kontabël te Autorizuar ne ato raste kur emvrimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet ne bazë të ligjit.

NENI 15

VITI FINANCIAR

15.1 Viti Financiar i Shoqerise fillon më 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti.

NENI 16

BILANCI VJETOR

16.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe te Ekspertit

AKT THEMELIMI DHE STATUT: "Apex Smart Solutions" SH.P.K


Kontabel te Autorizuar (nese jane emeruar) miratohen nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori i paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme raportin mbi administrimin e Shoqerise si edhe llogarite vjetore.

16.2 Dokumentet qe kane te bejne me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

**NENI 17
DIVIDEN
DI**

17.1 Pasi te jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqeria, me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese se Pergjithshme, mund te vendose shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

17.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe i bashkengjiten kuotave, te gjithë dividendet duhet te deklarohen dhe paguhen sipas shumave te paguara ne kuotat ne te cilat paguhet dividendi. Te gjitha dividendet do te shperndahen dhe paguhen ne menyre proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjate do pjese ose pjeseve te periudhes ne te cilen paguhet dividendi.



Three blue ink signatures are present at the bottom of the page, arranged horizontally from left to right. The first signature is a large, stylized loop. The second is a more complex, multi-lined signature. The third is a shorter, more compact signature.

AKT THEMELIMI DHE STATUT "Apex Smart Solutions"
SH.P.K.

KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I
ZBATUESHEM, ZGJIDHJA E
MOSMARREVESHJEVE

NENI 18
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

18.1 Ne rastin e prishjes dhe likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

NENI 19
LIGJI I ZBATUESHEM

19.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plate me kete Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

NENI 20
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

20.1 Mos marrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet ortakeve dhe trashegimtareve te ortakeve ose ortakeve te tjere dhe/ ose Shoqerise, qe kane per objekt te drejta te lidhura me Shoqerine, do te zgjidhen miqesisht ndermjet paleve te interesuara. Ne rast se palet nuk arrijne nje zgjidhje miqesore, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe:

ORTAKET E SHOQERISE: "Apex Smart Solutions" SH.P.K.

Arnold Kovaci

Arnold Kovaci


Evisjon Salku

Evisjon Salku


Irsid Salku

Irsid Salku
